NEWSLETTER

SHTATOR 2026

UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS

UBT marrëveshje me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Një hap i rëndësishëm për më shumë praktika, mundësi dhe orientim për studentët, por edhe për forcimin e bashkëpunimit akademik e shkencor në funksion të zhvillimit të bujqësisë shqiptare.

Lexo në faqen 4

Misioni i 27-të BOKU–UBT

Fokusi te programet e reja të studimit dhe zbatimi i reformës akademike

Dita e parë iu kushtua në mënyrë të veçantë programeve të reja Bachelor dhe Master dhe fazës konkrete të zbatimit të tyre. Punimet u hapën nga Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Fatbardh Sallaku, dhe Prof. Dr. Hubert Hasenauer nga BOKU University, me pjesëmarrjen e drejtuesve të Universitetit, përgjegjësve të departamenteve, koordinatorëve të programeve dhe ekipit të ekspertëve të BOKU. Në fokus nuk ishte vetëm ajo që është projektuar gjatë muajve të reformës, por sidomos çfarë është realizuar deri tani dhe çfarë mbetet për t'u bërë për nisjen dhe funksionimin e programeve të reformuara. **Vazhdimi në faqen tjetër...**

Një tjetër etapë e procesit të transformimit të universitetit
Strategjia UBT-BOKU 2030

Në fokus nuk ishte vetëm ajo që është projektuar gjatë muajve të reformës, por sidomos çfarë është realizuar deri tani dhe çfarë mbetet për t'u bërë për nisjen dhe funksionimin e programeve të reformuara. Zëvendësrektori Prof. Dr. Ilir Kapaj prezantoi ecurinë e programeve Bachelor, duke u ndalur te nevojat e identifikuara në takimet e mëparshme, masat e realizuara dhe çështjet që kërkojnë ende zgjidhje.

Një pjesë e rëndësishme e ditës ishte diskutimi i drejtpërdrejtë me koordinatorët e 12 programeve Bachelor, të cilët sollën në tryezë progresin, sfidat dhe nevojat konkrete të secilit program.

Vëmendje e veçantë iu kushtua edhe reformimit të programit të Mjekësisë Veterinare, ku Prof. Dr. Ilir Kapaj dhe Prof. Asoc. Dr. Xhelil Koleci prezantuan statusin aktual të procesit. Më pas, puna vijoi me 18 programet Master, ku koordinatorët diskutuan arritjet e deritanishme, sfidat dhe hapat që duhen ndërmarrë për konsolidimin e ofertës së re akademike të UBT-së.

Por reforma akademike nuk mund të ecë e shkëputur nga mënyra se si funksionon Universiteti. Për këtë arsye, paralelisht me diskutimet mbi programet, ekspertët e UBT-së dhe BOKU zhvilluan një sesion të posaçëm mbi nevojat administrative dhe përshtatjen e proceseve të brendshme me strukturën e re. Diskutimi u përqendrua te mënyra se si administrata mund të mbështesë më mirë mësimdhënien dhe kërkimin shkencor, duke përfshirë menaxhimin e kampusit, investimet, financat dhe proceset që lidhen drejtpërdrejt me administrimin e programeve të reja.

Dita e parë e misionit shënoi kështu kalimin nga projektimi i reformës te zbatimi i saj në terren: programe të reja, përgjegjësi të qarta dhe një strukturë akademike e administrative që duhet t'i përgjigjet modelit të ri të Universitetit. Në dy ditët në vijim, puna u zhvendos te roli dhe organizimi i departamenteve, kërkimi shkencor dhe përcaktimi i hapave të ardhshëm të procesit UBT–BOKU. **Lexo më shumë...**

UBT reformon programet e doktoratës

Më shumë lidhje me kërkimin shkencor dhe hapje ndërkombëtare

Në qendër të modelit të ri është krijimi i një lidhjeje të drejtpërdrejtë mes temave të doktoratës dhe projekteve kërkimore që zhvillohen në Universitet. Pedagogët dhe kërkuesit e UBT-së që kanë fituar projekte kombëtare apo ndërkombëtare do të kenë mundësi të propozojnë tema doktorature të lidhura me objektivat, veprimtaritë dhe rezultatet e këtyre projekteve.

Kjo qasje synon që doktoratura të mos mbetet vetëm një proces individual akademik, por të shndërrohet në një angazhim të strukturuar kërkimor dhe profesional. Doktorantët do të kenë mundësi të përfshihen në grupe kërkimore, laboratorë, punë eksperimentale, mbledhjen dhe analizën e të dhënave, publikime shkencore, konferenca dhe mobilitete ndërkombëtare.

Mundësi financimi përmes projekteve
Doktoraturat hapen edhe për kandidatët ndërkombëtarë
Një proces i hapur dhe konkurrues

Lexo më shumë...

Nënshkruhet marrëveshje e re bashkëpunimi mes UBT dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Një hap i rëndësishëm për të krijuar më shumë mundësi praktike dhe profesionale për studentët, për t'i afruar ata më shumë me realitetin e sektorit dhe për t'u ofruar orientim më të mirë drejt tregut të punës.

Kjo marrëveshje synon gjithashtu forcimin e bashkëpunimit akademik dhe shkencor, duke nxitur shkëmbimin e njohurive, ekspertizës dhe eksperiencave në funksion të zhvillimit të mëtejshëm të bujqësisë shqiptare.

Investimi te të rinjtë, te arsimi dhe te dija është investim te e ardhmja. Duke lidhur më fort universitetin me sektorin e bujqësisë, krijojmë më shumë hapësira për inovacion, kërkim shkencor dhe përgatitjen e profesionistëve që do të kontribuojnë në zhvillimin e këtij sektori. **Lexo më shumë...**

UBT-CIHEAM
Bashkëpunimi historik hyn në një fazë të re

Kishim kënaqësinë të prisnim në UBT një delegacion të CIHEAM – Mediterranean Agronomic Institute of Bari, të kryesuar nga Drejtori Ekzekutiv, Dr. Biagio Di Terlizzi. Takimi ishte një mundësi për të rikonfirmuar marrëdhënien e ngushtë dhe historike ndërmjet UBT-së dhe CIHEAM-Bari, një partneritet që ndër vite ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në forcimin e kapaciteteve akademike dhe profesionale të universitetit, përmes trajnimeve, kurseve të specializuara, projekteve të përbashkëta dhe shkëmbimit të ekspertizës. Shumë anëtarë të stafit akademik të UBT-së kanë kryer studime, trajnime apo qëndrime profesionale pranë këtij Instituti.
Sot, ky bashkëpunim synon të marrë një dimension të ri.

Në kuadër të reformës së UBT dhe orientimit të tij drejt një universiteti më kërkimor, më të lidhur me ekonominë dhe më aktiv në shërbim të shoqërisë, u diskutua për zgjerimin e bashkëpunimit në projekte të përbashkëta, kërkim shkencor, transferim teknologjie, ekspertizë dhe konsulencë. Ky orientim është në përputhje të plotë edhe me filozofinë e reformës së UBT-së: më shumë kërkim, më shumë ndërveprim me institucionet dhe ekonominë, më shumë transferim të dijes dhe teknologjisë dhe, mbi të gjitha, një rol më të madh të universitetit në shërbim të shoqërisë. **Lexo më shumë...**

UBT përmbyll projektin PEVULOS, një eksperiencë që kthehet në kapacitete të reja akademike

Pas tre vitesh bashkëpunimi, Universiteti Bujqësor i Tiranës organizoi Konferencën Përfundimtare të projektit PEVULOS, duke prezantuar rezultatet dhe ndikimin e tij në Shëndetin Publik Veterinar dhe Sigurinë Ushqimore. Projekti PEVULOS, i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian përmes Erasmus+ Capacity Building in Higher Education (CBHE), ka bashkuar universitete dhe institucione nga Bashkimi Evropian dhe Ballkani Perëndimor, me synim forcimin e arsimit pasuniversitar dhe kapaciteteve profesionale në këtë fushë.

Rezultatet e PEVULOS shkojnë përtej vetë programit. Për studentët, projekti ka sjellë më shumë mësim praktik dhe në terren, mundësi ndërkombëtare dhe një lidhje më të fortë mes teorisë dhe praktikës profesionale. Për stafin akademik ka krijuar qasje të reja në mësimdhënie, materiale dhe burime digjitale, shkëmbim ndërkombëtar ekspertize dhe bashkëpunim më të fortë akademik. Në nivel fakulteti, projekti ka ndihmuar në krijimin e kapaciteteve të reja për arsimin pasuniversitar, modernizimin e mjedisit të të nxënit dhe forcimin e rrjetit akademik ndërkombëtar. **Lexo më shumë...**



Biochar-i si një zgjidhje për mbetjet organike dhe trajtimin e ujit, workshop në UBT

Nga mbetjet organike te pastrimi i ujit: si mund të ndihmojë biochar-i?
Kjo ishte në qendër të ditës së parë të Workshop-it BAAWas, që po zhvillohet më 21–24 shtator 2026 në UBT dhe në Belsh. Workshop-i u hap nga Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Fatbardh Sallaku, dhe drejtuesi i Departamentit të Mjedisit dhe Burimeve Natyrore, Prof. Dr. Ferdi Brahushi.

Më pas, Dr. Aleksandër Peqini, Prof. Dr. Rolf-Alexander Düring dhe Prof. Dr. Sven Pohl prezantuan situatën e mbetjeve organike në Shqipëri, potencialin e tyre për prodhimin e biochar-it, objektivat e projektit, si dhe aspektet teknike të prodhimit dhe përdorimit të tij. Në fokus ishte ndotja e ujërave nga aktiviteti bujqësor dhe ujërat e ndotura. U prezantuan rezultate nga testimet me terbuthylazine, si dhe një zgjidhje e propozuar për Belshin, që kombinon një ligatinë artificiale me biochar-in për trajtimin e ujit.

U diskutuan gjithashtu praktikat aktuale të menaxhimit të mbetjeve organike dhe potenciali i tyre si lëndë e parë për prodhimin e biochar-it. **Lexo më shumë...**

Burimet ujore shqiptare testohen për prodhimin e birrës: 48 mostra nga 12 burime natyrore

A mund të ndikojë origjina e ujit në shijen dhe karakteristikat e birrës?

Kjo është pyetja që po eksplorohet përmes projektit "Vlerësimi i cilësisë së burimeve ujore të Shqipërisë për përdorimin në industrinë ushqimore", me fokus përdorimin e ujërave natyrore shqiptare në prodhimin e birrës. Janë analizuar 48 mostra uji nga 12 burime natyrore, të monitoruara gjatë katër stinëve, për të vlerësuar përbërjen e tyre hidrokimike dhe ndikimin e profileve minerale në fermentim dhe në karakteristikat e birrës Pale Ale.

Gjatë workshop-it, Dr. Fatbardha Lamçe prezantoi rezultatet e karakterizimit hidrokimik sezonal, ndërsa MSc. Julian Karajuli trajtoi ndikimin e përbërjes minerale të ujit në fermentim dhe në karakteristikat fiziko-kimike të birrës. Duke qenë se uji përbën mbi 90% të birrës, origjina dhe përbërja e tij mund të luajnë një rol të rëndësishëm në produktin përfundimtar.

Projekti, i koordinuar nga Prof. Asoc. Dr. Oneida Kyçyk, synon të krijojë një bazë shkencore për përdorimin e qëndrueshëm të burimeve ujore vendase në industrinë ushqimore dhe veçanërisht në prodhimin e birrës. Projekti mbështetet financiarisht nga AKKSHI.
Lexo më shumë...

UBT pret rreth 600 studentë europianë në Kampionatin Europian Universitar të Sporteve Luftarake

Universiteti Bujqësor i Tiranës u bë pjesë e një prej aktiviteteve më të mëdha studentore europiane të vitit 2026, duke mirëpritur rreth 600 studentë nga universitete të ndryshme europiane, në kuadër të Kampionatit Europian Universitar në sportet luftarake.

Në ambientet e UBT-së u zhvilluan takimet teknike të aktivitetit, në bashkëpunim me Federatën Shqiptare të Sportit Universitar, duke i dhënë universitetit një rol të rëndësishëm në këtë organizim ndërkombëtar.

Nga 8 deri më 16 shtator, Tirana mirëpriti rreth 1,600 studentë europianë, në një aktivitet që bashkon sportin, universitetet, kulturën dhe shkëmbimin mes të rinjve nga vende të ndryshme të Europës.

Një mundësi e veçantë për të promovuar Tiranën dhe Shqipërinë, si dhe për të forcuar lidhjet dhe bashkëpunimin mes universiteteve europiane. **Lexo më shumë...**